

KARTELE INFORMATIVE

AL095002

1. Emri i shërbimit	Apikim dhe dorëzim dokumentacionit për kryerjen e procedurave për privatizim objektiv të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, për familjet të cilat janë të miratuara sipas listës emërore të VKM /ose/ listës emërore të dërguar nga organet			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Kryerja e procedurave me qëllim privatizimin e banesave në favor të banorëve posedues/familjeve, sipas listave emërore bashkëlidhur VKM-ve, ose sipas listave emërore të konfirmuara nga organet e vetëqeverisjes vendore.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Apikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit për kryerjen e procedurave për privatizim objektiv miratuar me VKM-të përkatëse			
4. A jam përfitues?	Qytetarët/familjet e miratuar sipas listave emërore bashkëlidhur VKM-ve apo sipas listave emërore të konfirmuara nga organet e vetëqeverisjes vendore.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Kërkesë me shkrim e qytetarit për privatizimin e apartamentit të miratuar.	Aplikanti	Po
	2	Certifikatë e gjendjes familjare pas ditës së hyrjes në fuqi të aktit respektiv përkatës;	Zyra e Gjendjes Civile	Po
	3	Vërtetim përkatës nga punëdhënësi për vendin e punës/pozicion dhe të ardhurat neto të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes që janë në marrëdhënie pune	Punëdhënësi	Po
	4	Vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesit pranë njësive bashkiake përkatëse për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuara;	Njësia Administrative	Po
	5	Vërtetim nga zyra e punësimit të njësive vendore përkatëse, për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;	Zyra e punës	Po
	6	Vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension;	Sigurimet shoqërore	Po
	7	Dokument nga organet tatimore kur kryefamiljari apo anëtarët e familjes ushtrojnë aktivitet privat.	Drejtoria e Tatimeve	Po
8	Deklaratë e noterizuar nga ana e aplikantit për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur	Aplikanti	Po	
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Enti Kombëtar i Banesave	Tiranë; Durrës; Elbasan; Korcë; Gjrokastër; Fier; Vlorë; Berat; Lezhë; Shkodër; Kukës; Dibër.	Dega Tiranë: Rruga e Kavajës Godina e ish shtëpisë botuese "Naim Frashëri" Nd.80 H.1 K.5; Dega Fier: Lagja 11 Janari prapa prefekturës Fier; Dega Durrës: Lagja 12 Rruga: Koço Kazanxhi Durrës; Dega Vlorë: Lagja Pavarësia Rruga Pelivan Leska; Dega Gjrokastër: Lagja 18 Shtatori Rruga Studenti K.1; Dega Berat :Lagja 30 Vjetori Bulevardi Republika P.Nr.6 K.5; Dega Elbasan: Rr.Kongresi i Elbasanit P.71/1.K.1; Dega Shkodër : Rr. Marin Bicikemi, Lagja Perlat Rexhepi, përballë hotel Kolping; Dega Dibër: Bulevardi Elez Isufi, Godina e Qarkut Dibër, kati V; Dega Korcë: Rruga Edit Durham; Dega Kukës : Sheshi Skënderbej, Godina e Bashkisë; Dega Lezhë: Rruga Luigi Gurakuqi, ish ndërtesa e Raifaisen, kati III;	E Hëna- E Enjte: 08.00-16.30 E Premte: 08.00- 14.00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Otrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Otrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Otrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa baze Shërbim pa pagesë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Afati kohor për lidhjen e kontratës është brenda 1 muaji (30 ditë) nga dorëzimi i dokumentacionit nga qytetari/familja dhe pasi të jetë konfirmuar nga Enti Kombëtar i Banesave/ (Degët Rajonale) që dokumentacioni është i saktë dhe i plotë.			
10. Çfarë përfitoj?	Kontrata përfundimtare e shitblerjes së banesës që merret nga Noteri (Kontratë e cilë nënshkruhet pas likuidimit total të vlerës së banesës.)			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Brenda 30 ditëve sipas detyrimit ligjor , nga marrja e kontratës përfundimtare qytetari/familja duhet të aplikojë pranë Zyrë së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vijimin e procedurave për kalimin e pronësisë në emër të tij.			
12. Ku e marr?	Në sportele	Me postë	E-albania	Me e-mail
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Enti Kombëtar i Banesave (EKB)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontaktat në: E- albania:e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al EKB web: www.ekb.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Orari Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E Hënë- E Premte, ora 08:00- 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele	Me postë	Web-i i Institucionit	Me e-mail
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Vendimet e Këshillit të Ministrave për privatizimet Udhëzimi i Ministrisë së Linjës (ish-MZHU) Nr. 17 datë 17.10.2012, i ndryshuar			